



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KZAZ-VE NR. 11, 14, 27, 41, 42, 43, 47, 52, 56, 89 DHE SEKRETARËVE TË EMËRUAR KRYESISHT TË KZAZ-VE NR. 24, 36, 54, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019.**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 21.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për lirim dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve nr. 11, 14, 27, 41, 42, 43, 47, 52, 56, 89 dhe sekretarëve të emëruar kryesisht të KZAZ-ve nr. 24, 36, 54, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 30, neni 31, neni 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

**V Ë R E N**

Partia Socialiste e Shqipërisë, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, ka kërkuar:

- me shkresën nr. 11493, datë 13.06.2019:
- lirim të anëtarit të KZAZ nr. 14, z. Jurgen Kola dhe emërim të z. Gëzim Kaçorri;
- me shkresën nr. 11560, datë 14.06.2019:
- lirim të anëtarëve të KZAZ nr. 42, zj. Megi Katroshi, z. Andi Kala, z. Rovin Dranga dhe emërim në vend të tyre të z. Armand Xhafa, z. Sulejman Merkja dhe z. Denis Haveriku;
- me shkresën nr. 11829, datë 17.06.2019:



**Nr. 846 i Vendimit Data 21.06.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit**

Për lirim dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve nr. 11, 14, 27, 41, 42, 43, 47, 52, 56, 89 dhe sekretarëve të emëruar kryesisht të KZAZ-ve nr. 24, 36, 54, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

- lirim të anëtarit të KZAZ nr. 47, z. Hipokrat Biba dhe anëtares të KZAZ nr. 48, zj. Jonida Marishta dhe emërim anëtar të KZAZ nr. 47 të zj. Jonida Marishta dhe anëtar të KZAZ nr. 48 z. Hipokrat Biba;
  - me shkresën nr. 11855, datë 18.06.2019:
- lirim të anëtares së KZAZ nr. 43, zj. Griselda Kaçani dhe emërim të z. Elvis Kaçani;
- lirim të dy anëtarëve të KZAZ nr. 56, z. Andi Bullari, zj. Amarda Sina dhe emërimin e z. Edi Veliu, zj. Bruna Metani;
- lirim të anëtares së KZAZ nr. 89, zj. Emanuela Thanu dhe emërim të zj. Milica Drapo.
  - me shkresën nr. 11908, datë 19.06.2019:
- lirim të anëtarit të KZAZ nr. 11, z. Donald Korbi dhe emërim të z. Defrim Korbi;
- lirim të anëtares të KZAZ nr. 27, zj. Antika Bushi dhe emërim të z. Vangjel Kaziu;
- lirim të anëtares së KZAZ nr. 52, zj. Argela Llushi dhe emërim të z. Joan Gjeta;
- lirim të anëtares së KZAZ nr. 41, zj. Jonida Rudaj dhe emërim të zj. Eneida Doku.

Propozimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për lirim dhe emërim të anëtarëve të KZAZ-ve janë në përputhje me kërkesat e nenit 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor.

- Me shkresën nr. 10871 prot., datë 07.06.2019, sekretari i KZAZ nr. 24, z. Teodor Labi, emëruar kryesisht nga KQZ me vendimin 173, datë 16.04.2019 për arsye objektive ka paraqitur dorëheqjen.
- Me shkresën nr. 11566 prot., datë 14.06.2019, sekretarja e KZAZ nr. 54, zj. Nexhmije Daullja, emëruar kryesisht nga KQZ me vendimin 141, datë 09.04.2019 për arsye objektive ka paraqitur dorëheqjen.

Në listën e shtetasve miratuar nga KQZ me vendimin nr. 140, datë 9.04.2019, pas plotësimit të vakancave të KZAZ me emërimet kryesisht nga KQZ, nuk rezultojnë shtetas të paemëruar me arsim juridik dhe vendbanim në Bashkinë Durrës dhe Bashkinë Lushnjë.

Në shqyrtim të kërkesave të shtetasve, në përgjigje të njoftimit publik të KQZ-së, por që për shkak të paraqitjes në tejkalim të afatit të përcaktuar, nuk janë bërë pjesë e lidhjes 1 të vendimit nr. 140, datë 09.04.2019, rezulton se:

- z. Shaziman Hoxha, shtetas me vendbanim në Bashkinë Durrës, me arsim juridik;
- zj. Alda Goga, shtetase me vendbanim në Bashkinë Lushnjë, me arsim juridik;

kanë paraqitur kërkesë për t'u emëruar kryesisht sekretarë të KZAZ-ve, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenet 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor dhe i propozohen KQZ-së për t'i emëruar kryesisht sekretar të KZAZ nr. 24 dhe KZAZ nr. 54.

- Me shkresën nr. 10015 prot., datë 06.06.2019, sekretarja e KZAZ nr. 36, zj. Matilda Hyseni, emëruar kryesisht nga KQZ me vendimin 141, datë 09.04.2019 për arsye objektive ka paraqitur dorëheqjen.



KQZ bazuar në nenin 32, pika 2, të Kodit Zgjedhor, liron nga detyra sekretaren e emëruar kryesisht dhe plotëson vakancën duke përzgjedhur nga lista e shtetasve të miratuar nga KQZ me vendimin nr. 140, datë 09.04.2019.

Për zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, plotësojnë kushtet për emërimin në pozicionin e sekretarit të KZAZ nr. 36, shtetasit:

1. Erald Haxhi Ismaili;
2. Adi Shpëtim Muja;
3. Ornela Përparim Hida;
4. Eldorad Pirro Kice;

KQZ, në zbatim të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", përzgjedhi përmes procedurës së shortit për plotësimin e vakancës së krijuar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 30, nenin 31, nenin 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

### **V E N D O S I:**

1. Të lirojë nga detyra anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve sipas lidhjes 1.
2. Të emërojë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve sipas lidhjes 2.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 846 i Vendimit Data 21.06.2019 e Vendimit Ora 10:00 e Vendimit**

Për lirimin dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve nr. 11, 14, 27, 41, 42, 43, 47, 52, 56, 89 dhe sekretarëve të emëruar kryesisht të KZAZ-ve nr. 24, 36, 54, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.